REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: Primljeno: | 19.01.2024 | |
|---|---|---|
| Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 05-020/04-4353 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS-së bënë këtë:

# NJOFTIM PUBLIK
# PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTAR NË KOMISIONIN VLERËSUES PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE TË OJQ-VE

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të shoqërisë civile se mund ti dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet më qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të financimit të projekteve, të OJQ-ve të cilat kanë aplikuar sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-841 të datës 04.01.2024.

Ky Komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin e projekteve të OJQ-ve për zbatimin e objektivave Kulturore, Rinore dhe rekreative me rastin e Pavarësisë së Kosovës. sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-841 të datës 04.01.2024. ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga OJQ-të
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësin e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen Drejtoratit për Kultuër, Rini dhe Sport dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për shërbime me qytetar sporteli nr. 1 dhe 2 më së largu deri me datë 25.01.2024.

Lipjan, më 19.01.2024

Drejtoreshë e DKRS-së
Anila Reçica-Llugiqi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT LIPJAN OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO